



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1906/783/KPM/mf

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafin 2 pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në takimin e mbajtur me datë 17 qershor 2019, mori këtë:

VENDIM

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilët nuk transmetojnë përmes rrjetit tokësorë lirohen nga lista e bartjes së obligueshme. Ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale me transmetim tokësorë (me frekuenca) mbesin pjesë e bartjes së obligueshme.

ARSYETIM

KPM, më 5 qershor 2019 ka pranuar një kërkesë me shkrim nga Oda Ekonomike e Kosovës përmes të cilës ka kërkuar nga KPM të iniciohet procedura e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

KPM gjenë se Oda Ekonomike e Kosovës përmes kësaj kërkesë për ndryshim të Rregullores, konkretisht rregullit për bartje të detyrueshme, e arsyeton se ky rregull i vë në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale, në raport me operatorët e shpërndarjes dhe nuk iu lejon rregullim të marrëdhënieve kontraktuale në mes tyre.

OSHMA-të e liruar nga bartja e detyrueshme obligohen që, sinjalin e tyre ta ofrojnë mi baza jo ekskluzive dhe jo-diskriminuese, në mënyrë që publiku mos të përjashtohet nga informimi.

OSHMA-të obligohen që përcaktimet komerciale për ofrimin e sinjalit tek operatorët e shpërndarjes të jenë të favorshme, të arsyeshme dhe të bazuara mbi kushtet dhe rrethanat ekzistuese të tregut;

KPM e gjenë si të bazuar kërkesën e Odës Ekonomike të Kosovës përmes të cilës e vë në pah pozitën e pabarabartë dhe diskriminuese të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale në raport me operatorët e shpërndarjes.

HYRJA NË FUQI

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër të KPM-së për këtë çështje.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



24.06.2019
data